



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:024470
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05610915

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit K.. L.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.2743/22 të datës 26.01.2023, jashtë seancës gjyqësore me datë 23.04.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 22.04.2024, lidhur në mes të pandehurit K.. L.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P...

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.2743/22 të datës 26.01.2023.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit **K.. L..**, i lindur më 14.05.1985 në Pejë, me vendbanim në Rr “V.. D..” në Pejë, i b... i R.., dhe nënës B..., e vajzërisë M.., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtorë privat, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr., posedues i nr. të telefonit, i nacionalitet shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 26.01.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.2743/22 ndaj të pandehurit K.. L.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 par. 1 të KPRK-së.

Me datën 22.04.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimi në mes të pandehurit K.. L.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P.., me nr, Nd.nr../.. e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës në kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës 22.04.2024, lidhur në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P...

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2023:024470, 23.04.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gj y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi